

RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS

RAPORTI VJETOR 2008



Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

Rr. Hajdar Dushi C-2 II/8

Prishtinë, Kosovë

Telefoni: +381 (0) 38 245 850

info@womensnetwork.org

www.womensnetwork.org



RRJETI I GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS RAPORTI VJETOR 2008

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës

+381 (0) 38 245 850

info@womensnetwork.org

Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8

Prishtinë, Kosovë

www.womensnetwork.org

MISIONI I RRJETIT TË GRUPEVE TË GRAVE TË KOSOVËS (RRGGK)

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK) mbështet, mbron dhe promovon të drejtat dhe interesat e grave dhe vajzave anembanë Kosovës, pa dallim për sa i përket mendimit politik, fesë, moshës, nivelit të arsimit, orientimit seksual dhe aftësisë. RrGGK përmbush misionin e vet përmes këmbimit të përvojave dhe informatave, partneriteteve dhe rrjetëzimeve, avokimit dhe hulumtimit.

PËRMBAJTJA

Fjala e Kryetares së Bordit dhe Drejtoreshës Ekzekutive	2
Objektivat e RrGGK-së	4
Lidhur me këtë Raport	5
Ngritja e Nivelit të Pjesëmarrjes së Grave në Politikë & Vendimmarrje	6
Fuqizimi i Votuesve	10
Përmirësimi i Shëndetit të Grave	12
Zbritja e Nivelit të Trafikimit dhe Dhunës në Familje	13
Rritja e Përfshirjes së Grave në Ndërtimin e Paqes në Nivel Rajonal	17
Fuqizimi i Kapaciteve të RrGGK dhe Shërbimit të Anëtareve tona	19
Bordi i Drejtorëve i RrGGK-së	25
Anëtarët e Stafit të RrGGK-së	26
Raporti Financiar 2008 i RrGGK-së	27
Lista e donacioneve nga RrGGK	30
Strategjia e RrGGK-së për vitin 2009	32
Organizatat Anëtare të RrGGK-së	33

FJALA E KRYETARES SË BORDIT DHE DREJTORESHËS EKZEKUTIVE

Të nderuara anëtare të Rrjetit dhe përkrahës të saj,

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës synon që përmes aktiviteteve të veta dhe në bashkëpunim me institucionet tona dhe organizatat partnere ndërkombëtare, të ndihmoj në arritjen e barazisë gjinore në Kosovë, kështu që edhe gjatë vitit 2008 zhvilloi aktivitete të rëndësishme për avancimin e pozitës së gruas.

Mekanizmat për arritjen e barazisë gjinore janë krijuar në të gjitha nivelet e qeverisjes, por zbatimi i tyre mbetet i ngadalshëm për shkak të përkufizimeve financiare dhe mungesës së vullnetit të zyrtarëve në nivelet më të larta të vendimmarrjes.

Ligji për Barazi Gjinore, Ligji Kundër Diskriminimit, Ligji për Familjen, Programi i Kosovës për Barazi Gjinore dhe Strategjia për të Drejtat e Njeriut në Republikën e Kosovës, paraqesin një arritje të theksuar në drejtim të arritjes së barazisë gjinore dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut në mënyrë më gjithëpërfshirëse në Kosovë. Megjithatë, për t'u arritur mbrojtja efektive e të drejtave njerëzore të grave kërkohet edhe zbatimi i duhur i legjislacionit në fuqi si dhe zbatimi i marrëveshjeve dhe instrumenteve ndërkombëtare.

Dhuna dhe ngacmimet seksuale ndaj grave kanë shënuar rritje, e dhënë kjo që reflekton në hulumtimin e bërë nga RrGGK "Siguria fillon në shtëpi" publikuar në Tetor të vitit 2008. Në raport dhuna në familje paraqitet me shifra alarmante ndërsa rekomandon përpilimin e ligjit dhe strategjisë kundër dhunës në familje.

Ne përshëndesim përpjekjet e Agjensionit për Barazi Gjinore të Zyrës së Kryeministrit, me përkrahje të UNDP/WSSI, për të përpiluar ligjin dhe planin strategjik kundër dhunës në familje. Ne ftojmë të gjitha institucionet të përfshihen në këtë proces dhe të angazhojnë qoftë burime financiare apo edhe ato njerëzore për

të parandaluar dhunën, për të mbrojtur viktimat dhe për të ndjekur penalisht autorët e krimit. Ndërsa ne duhet të vetëdijesojmë qytetarët për këto mekanizma të reja sapo që ato të adoptohen nga Parlamenti i Kosovës.

Akoma kemi shumë punë për të bërë. Duhet të vazhdojmë të monitorojmë implementimin e ligjeve ekzistuese dhe funksionimin e mekanizmave institucional. Duhet t'u kërkojmë politikanëve të zgjedhur me vota të qytetarëve, llogari për premtimet e bëra. Duhet të njoftojmë gratë dhe vajzat për të drejtat e tyre përmes fushatave që do të zhvillohen gjatë vitit 2009.

Dëshirojmë t'i falënderojmë anëtarët e RrGGK-së për përkushtimin e tyre të vazhdueshëm për rrjetin dhe përpjekjet e tyre që zëri i grave të dëgjohet. Falënderojmë anëtarët e Bordit për përkrahjen dhe kontributin e tyre.

Gjithashtu, falënderojmë përkrahësit tonë financiar të cilët besojnë në punën tonë. Dhe një falënderim i veçantë për mediat për përkrahje të vazhdueshme rreth aktiviteteve tona. Ne në RrGGK angazhohemi për bashkëpunim të mëtejshëm me ju dhe shpresojmë se ky do të jetë edhe një vit tjetër aktiv dhe i suksesshëm.

Sinqerisht,

Belgjyzare Muharremi, Kryetare e Bordit të RrGGK-së

Igballe Rogova, Drejtore Ekzekutive e RrGGK-së

OBJEKTIVAT E RRGGK

- I.** Të sigurojë pjesëmarrje të barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimin politik, ekonomik dhe social të Kosovës;
- II.** Të përmirësojë të drejtat njerëzore të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë; dhe
- III.** Të përmirësojë dhe ngrisë nivelin e bashkëpunimit mes grupeve dhe organizatave të grave në Kosovë, rajon dhe kontekst ndërkombëtar.

LIDHUR ME KËTË RAPORT

Ky raport mbi aktivitetet që mbulon periudhën mes 1 dhjetorit 2007 dhe 1 dhjetorit 2008 shërben për të informuar anëtarët, partnerët dhe miqtë e RRGGK-së mbi të gjitha aktivitetet dhe të arriturat e shënuara gjatë vitit të kaluar. Ky raport është ndarë në seksione, në pajtim me zonat programatike të RRGGK-së që janë identifikuar paraprakisht nga Bordi i Drejtorëve:

- 1.** Ngritja e nivelit të pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje
- 2.** Fuqizimi i votuesve
- 3.** Përmirësimi i shëndetit të grave
- 4.** Zbritja e nivelit të trafikimit dhe dhunës familjare
- 5.** Ngritja e nivelit të përfshirjes së grave në ndërtimin e paqes në rajon
- 6.** Fuqizimi i kapaciteteve të rrjetit

Raporti gjithashtu përmban raportin financiar të RRGGK-së për vitin 2008. Në fund të tij ofrohet një pasqyrë e aktiviteteve të planifikuara për secilën fushë programatike të lartpërmendur për vitin 2009.

NGRITJA E NIVELIT TË PJESËMARRJES SË GRAVE NË POLITIKË DHE VENDIMARRJE

U takuan përfaqësuesit e ri të Kuvendit të Kosovës me përfaqësuesit e Shoqërisë Civile

Më 22 janar, zyra Franceze organizoi një forum si pjesë e projektit të financuar nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, me temën "Kuvendi dhe shoqëria civile – këmbimi i praktikave më të mira", në Grand Hotel Prishtina. Krahas prezantimeve të bëra nga përfaqësuesit tjerë të shoqërisë civile, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK-së foli mbi "Përmirësimin e bashkëpunimit aktiv mes Qeverisë së Kosovës dhe shoqërisë civile". Ajo tha që shoqëria civile duhet të luaj rol aktiv në dhënie të ndihmës për institucione. Ajo gjithashtu kritikoi deputetët e mëparmë që më shumë dëgjonin zyrtarët e UNMIK-ut se sa vetë qytetarët që i kishin zgjedhur. Nga ky forum dolën rekomandime për Kuvendin e ri, përfshirë edhe rekomandimin për hapjen e një zyre për përfaqësuesit e shoqërisë civile, e cila do punonte në ngritjen e nivelit të bashkëpunimit mes përfaqësuesve politikë dhe atyre të shoqërisë civile. Drejtoresha Ekzekutive e RRGK-së kundërshtoi këtë ide, duke theksuar se kjo do të limitonte bashkëpunimin, duke përcaktuar procedurat dhe duke institucionalizuar mënyrën se kur, si dhe ku shoqëria civile do t'i parashtrojë brengat e veta para qeverisë.

RRGK publikoi raportin mbi monitorimin e Rezolutës 1325 të KS të OKB-së

Më 5 dhjetor të vitit 2007, RRGK publikoi raportin mbi "Monitorimin e Implementimit të Rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë" në Grand Hotel Prishtina. Ky raport hulumtues ishte rezultat i intervistave me figura kyçe të jetës publike në Kosovë, përfshirë politikanët, aktivistët e shoqërisë civile, stafin e UNMIK-ut dhe persona kyç tjerë në pozita udhëheqëse në institucione Kosovare. Ky raport dokumenton dhe vlerëson nivelin e zbatueshmërisë së Rezolutës 1325 mbi Gratë, Paqen dhe Sigurinë në Kosovë. Persona të shumtë ishin të pranishëm në këtë publikim, përfshirë organizatat anëtare të RRGK-së, mediat, zyrtarë nga institucione qeveritare dhe përfaqësues të zyrave ndërkombëtare në Kosovë.

Mes folësve gjatë këtij evenimenti ishin edhe Menaxherja Rajonale e UNIFEM-it, Znj. Osnat Lubrani, Menaxherja e Projektit të UNIFEM-it për Kosovën, Znj. Flora Macula, Shqipe Krasniqi nga Agjencia për Barazi Gjinore, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK-së, Znj. Igballe Rogova, dhe Dafina Beqiri, hulumtuese që kontribuoi në përpilimin e këtij raporti.

Pjesëmarrësit vendosën të përgatisin një plan pune në bashkëpunim me ekspertë ligjorë dhe të çështjeve gjinore, duke u bazuar në rekomandimet që dolën nga ky raport. RRGK më pas organizoi një grup punues që përpiloi planin e punës, i cili thekson hapat konkretë që duhet ndërmarrë nga institucionet Kosovare në drejtim të implementimit të Rezolutës 1325. RRGK mbajti një takim më 8 mars, në Grand Hotel, gjatë të cilit në praninë e organizatave anëtare, ekspertëve për çështje gjinore dhe përfaqësuesve qeveritarë u finalizua ky plan.

Përfaqësuesja e RRGK-së foli para Komisionit Evropian dhe Parlamentit Evropian

Më 28 shkurt, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK-së Igballe Rogova, Deputetja e Kuvendit të Kosovës Edita Tahiri dhe Menaxherja e Projektit të UNIFEM-it Flora Macula folën para Komisionit për Barazi Gjinore në Parlamentin e BE-së në Bruksel. Më pas ato folën para Komisionit Evropian, duke iu falënderuar lidhjeve dhe përpjekjeve avokuese të UNIFEM-it, të cilët organizuan takimin. Në të dyja takimet, Rogova tha që misioni i BE-së i cili do zbarkojë në Kosovë (EULEX) duhet të mësojë nga gabimet e bëra nga misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara (UNMIK). Në pajtim me Rezolutën 1325, ky mision do duhej përfshirë gratë në të gjitha fazat e planifikimit programatik, përcaktimit të politikave dhe ndërtimin e paqes. UNMIK-u ka dështuar në këto sfera, theksoi ajo.

Mundësia për të folur para Parlamentit Evropian u dha si rezultat i pjesëmarrjes së RRGK-së në një konferencë me vendimmarrësit evropian në maj të vitit 2007 në Berlin, me temën "Harta drejt 1325: Perspektiva Gjinore në Bashkimin Evropian". Pas fjalimit të Rogovës atje, Ana Maria Gomes, deputete në Parlamentin e BE-së, sugjeroi që Rogova të flet para Parlamentit të BE-së. Që atëherë, Znj. Gomes avokoi krahas UNIFEM-it për takimin e lartpërmendur.

RRGK organizoi dhe mori pjesë në debate lidhur me Kushtetutën e re të Kosovës

RRGK ishte shumë aktiv në shqyrtimin e projekt Kushtetutës së re të Kosovës nga perspektiva gjinore dhe në dhënien e rekomandimeve për Komisionin për Hartimin e Kushtetutës. RRGK përfshiu organizatat e veta anëtare, aktivistët dhe qytetarët në dhënien e rekomandimeve për Komisionin. Anëtarët e komisionit, ekspertë të jurispo-

dencës, ekspertë të çështjeve gjinore dhe përfaqësues të BE-së morën pjesë në takime gjatë të cilave arritën të dëgjojnë brengat e qytetarëve.

Më 25 shkurt, RRGK dhe Instituti Kombëtar Demokratik (NDI) organizuan një debat lidhur me Kushtetutën me gratë parlamentare në Kuvend. Një nga çështjet kryesore që u ngritën ishte përfshirja e kuotës së përfaqësimit prej së paku 40% të të dyja gjinive në të gjitha nivelet e qeverisjes, përfshirë në Kuvend dhe ministri.

Më 26 shkurt, Zyra Këshillëdhënëse për Qeverisje të Mirë e Zyrës së Kryeministrit organizoi një debat në të cilin përfaqësuesja e RRGK-së foli mbi projekt Kushtetutën nga perspektiva gjinore. Ajo tha që projekt Kushtetuta ishte mjaft e zbehtë sa i përket sigurimit të balancit gjinor në të gjitha nivelet e vendimmarrjes politike, si dhe në sigurimin e të drejtave njerëzore të grave.

Më 1 mars, anëtarët e RRGK-së më tej diskutuan Kushtetutën me përfaqësueset të Komisionit për Hartimin e Kushtetutës Ministren e Drejtësisë Znj. Nekibe Kelmendi, Lirije Osmanin dhe Gjyjleta Mushkolaj dhe ekspertin për çështje gjinore Vjosa Dobrunën, në Restorantin Hani i 2 Robertëve. Krahas çështjes së kuotës u debatua nëse do duhej përfshirë në Kushtetutë edhe Rezolutën 1325. Përderisa një anëtare e Komisionit mendonte se kjo rezolutë është tejet ambicioze për tu implementuar nga institucionet e Kosovës dhe se nuk do duhej përfshirë, aktivistet e argumentuan këtë duke theksuar se ajo duhet përfshirë në mënyrë që Kosova t'i përmbahet standardeve ndërkombëtare. Përfshirja e Rezolutës 1325 në Kushtetutë do t'i siguronte aktivistëve kornizën ligjore për të kërkuar nga qeveria implementimin e saj. Në fund të takimit, RRGK i dorëzoi Ministres Nekibe Kelmendi një shpërblim në shenjë mirënjohje për përkrahjen e jashtëzakonshme që ajo i ka dhënë të drejtave të grave.

Më 2 mars, RRGK i dërgoi Komisionit rekomandimet e veta lidhur me Kushtetutën sipas të cilave ajo do duhej të përfshijë:

- Kuotën e pjesëmarrjes prej 40 përqind në të gjitha nivelet e qeverisë, sipas Ligjit për Barazinë Gjinore;
- Rezolutën e KS të OKB-së në listën e konventave dhe instrumenteve ndërkombëtare;
- Mekanizmat që i garantojnë Agjencisë për Barazi Gjinore mundësinë e sigurimit të implementimit dhe monitorimit të akteve ligjore ndërkombëtare dhe Kosovare që mëtojnë të arrijnë barazinë gjinore;
- Dispozitat që garantojnë të drejtat e barabarta pronësore për femra dhe meshkuj;
- Referencat specifike të barazisë në martesë sa i përket pronës dhe relacioneve personale mes

bashkëshortëve;

- Dispozitat që sigurojnë se punonjësit e të dy gjinive të marrin pagë të njëjtë për punë të njëjtë, si dhe të gëzojnë kushte dhe të drejta të njëjta në vend të punës; dhe
- Dispozitat që i garantojnë grave se nuk do të humbin shtetësinë pas martesës me të huaj.

RRGK bëri rekomandime për Misionin e BE-së në Kosovë

Më 10 tetor, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK-së foli në konferencën e emërtuar "Nga zotimi në veprim – BE u ndihmon grave në zona konflikti dhe pas konfliktit: Implementimi i Rezolutave 1325 dhe 1820 në misionet e BE-së: Përmirësimi i sigurisë së menjëhershme dhe afatgjatë të grave" të mbajtur në Komisionin Evropian në Bruksel. Ky takim i organizuar nga BE dhe UNIFEM, solli përreth tavolinës zyrtarë të lartë të BE-së dhe aktivistë nga EJK. Në fjalimin e saj gjatë panelit të dytë, Drejtoresha Ekzekutive e RRGK-së Igballe Rogova tha se akterët nga BE rrallë hynin në interakcion me aktivistet kosovare dhe rrallë dëgjojnë brengat e grave gjatë marrjes së vendimeve kyçe. Ajo bëri rekomandime specifike përmes të cilave misioni i ri i BE-së më mirë do t'i mbronte gratë në Kosovës.

FUQIZIMI I VOTUESVE

RRGGK lanson një mekanizëm të ri për qytetarët që t'i adresojnë brengat e tyre tek politikanët

Përmes projektit 'Zëri i votuesve', të lansuar më 16 shtator, votuesit mund të kontaktojnë RRGK-në për t'ua parashtruar ankesat dhe sugjerimet e tyre për politikanët apo politikat në nivel komunal apo kombëtar. Qytetarët mund të thërrasin në numrin pa pagesë (0800 201 401) çdo ditë pune mes orës 9.00 dhe 17.00, mund të dërgojnë email (në adresën zerivotuesve@gmail.com) apo të marrin pjesë në takime publike. Projekti është përkrahur nga Ambasada Britanike dhe Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK).

Iniciativa Zëri i Votuesve i mundëson qytetarëve që t'i bëjnë prioritetet e tyre të ditura për zyrtarët e zgjedhur, dhe krahas avokimit t'i detyrojnë politikanët që t'i trajtojnë nevojat e qytetarëve si prioritete dhe jo si obligime dytësore.

Nga 16 shtatori deri më 31 tetor, janë realizuar 610 thirrje në linjën e 'Zërit të Votuesve'. Brengat kryesore të popullatës ishin: korrupsioni i politikanëve; ndërprejet e rrymës; redukimet e ujit; mungesa e sistemeve të ujësjellësit, në veçanti në fshatrat ku banorët pinë ujë nga puset e patestuara; mungesa e sistemeve të kanalizimit në fshatra; dhe rrugët e paasfaltuara në zona rurale. Ata gjithashtu ankoheshin për nepotizëm, papunësi, varfëri, pensione dhe për situatën politike në Mitrovicën e Veriut. Qytetarët gjithashtu shprehën brengat e tyre gjatë takimeve publike të mbajtura në tetë komuna: Gjakovë, Vushtrri, Kastriot, Viti, Prizren, Drenas, Mitrovicë dhe Fushë Kosovë.

RRGGK publikoi raportin e vet të parë në të cilin paraqiti prioritetet e qytetarëve, publikim ky që përfitoi nga një mbulim i gjerë medial. Raporti më tej iu dorëzua Zëvendëskryeministrit Hajredin Kuçi dhe të gjithë deputetëve në parlament. Për të gjetur këtë raport, vizitoni faqen www.womensnetwork.org.

Dhjetëra mijëra qytetarë marshojnë për të mbrojtur Sovranitetin Kombëtar të Kosovës

Më shumë se 30,000 qytetarë marshuan nëpër rrugët e Prishtinës më 19 nëntor në protestën paqësore kundër planit gjashtëpikësh të Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së Ban Ki-Moon. Plani do t'i jepte Serbisë kompetenca administrative në zonat e banuara me shumicë serbe brenda Republikës së Kosovës, përfshirë policinë, gjyqësorin, transportin dhe infrastrukturën, kufijtë administrativë, doganat dhe objektet fetare. RrGGK ishte e përfshirë në organizimin e demonstratës bashkë me grupe tjera të shoqërisë civile. Gjashtë pikat kërcënojnë sovranitetin territorial të Kosovës, shkelin kushtetutën e Kosovës, janë në kundërshtim me Propozimin për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës të të Dërguarit të Posaçëm të OKB-së, Marti Ahtisaari, dhe rrezikojnë paqen e brishtë në Kosovës dhe Evropën Juglindore (EJL), thanë udhëheqësit e shoqërisë civile.



PËRMIRËSIMI I SHËNDETIT TË GRAVE

RRGGK i ndihmon Medica Kosova në ngritjen e fondeve

RRGGK i ndihmoi Medica Kosova në ngritjen e fondeve nga UNIFEM-Austria në mënyrë që të mund të vazhdojë me vizitat e grave në viset rurale me klinikën e vet mobile shëndetësore, për të kryer ekzaminimin mjekësor të grave të cilat përndryshe nuk kanë qasje në kujdes të tillë shëndetësor. Përmes këtyre ekzaminimeve mjekësore Medica Kosova arrin ta zbulojë kancerin e gjirit mjaft herët, si dhe të identifikojë brengat tjera serioze shëndetësore që prekin gratë në Kosovë.

RRGGK avokoi që Kushtetuta e re të mbulojë të drejtat riprodutive të grave

Kushtetuta e Republikës së Kosovës u miratua nga Kuvendi i Kosovës më 11 qershor. Përkundër përpjekjeve të disa grupeve fetare, në veçanti të grupeve 'pro-life' nga Amerika që vizitonin Kosovën në javët para miratimit të saj, Kushtetuta e mbron të drejtat riprodutive të grave. RRGK i ka dërguar Komisionit Kushtetues një deklaratë përmes të cilës i kundërvihet lobimeve të bëra nga delegacioni Amerikan. Në këtë letër, RRGK theksoi se Kushtetuta e Kosovës garanton të drejtat e grave për 'integritet personal', e drejtë kjo që përfshin 'të drejtën e marrjes së vendimeve lidhur me reproduktimin', ndërsa neni 25 thekson 'çdo individ nga lindja gëzon të drejtën në jetë'. Duke i kritikuar argumentet e grupeve 'pro-life' që thonin se jeta fillon nga mbarësimi, RRGK theksoi se 'në raste të aborteve spontane që ndodhin në muajt e parë të shtatëzanisë, asnjë institucion fetar nuk organizon funeral'. Pas kësaj letre dhe letrave tjera të dërguara nga grupe të ndryshme Kosovare të të drejtave të njeriut, Komisioni nuk i bëri ndryshime versionit të parë të projektkushtetutës. Rrjedhimisht, Kushtetuta mbron të drejtat njerëzore të Kosovareve për të gëzuar të drejtën riprodutive, të drejtën e formimit të familjes dhe atë të orientimit seksual.

RRGGK përkrahu marshin kundër kancerit të gjirit dhe organizatën Jeta Vita

Në tetor, Qendra Kosovare për Luftimin e Kancerit të Gjirit (QKLGJ) Jeta Vita, në partneritet me Iniciativën e Ballkanit për Kancer të Gjirit (BBCI) dhe Ambasadën e SHBA-ve në Kosovë, organizoi një fushatë për ngritjen e vetëdijes lidhur me kancerin e gjirit gjatë Muajt Ndërkombëtar për Luftimin e Kancerit të Gjirit. RRGK përkrahu këto përpjekje duke shpërndarë informatat lidhur me këtë marsh.

ZBRITJA E NIVELIT TË TRAFIKIMIT DHE DHUNËS NË FAMILJE

RRGGK mirëpret Rezolutën 1820 të KS të OKB-së mbi Dhunën Seksuale Ndaj Grave në Konflikt

Më 19 qershor të vitit 2008, Këshilli i Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në mënyrë unanime miratoi Rezolutën 1820, me të cilën dënohet dhuna seksuale ndaj grave në gjendje konflikti. RRGK përmes një deklaratë të dërguar përkrahu këtë rezolutë të re. Njëkohësisht, RRGK tërhoqi vëmendjen ndaj faktit se në vendet ku gratë dhunohen përditë dhe sundimi i ligjit është inekzistent, është pak e besueshme se kjo Rezolutë do të mund të zbatohet. Pyetja që parashtrrohet është kjo në vijim: si të bëjnë që palët në konflikt të armatosur të dënohen në rast të shkeljes së kësaj Rezolute?

Rezoluta nuk ofron mjete për zbatimin e drejtësisë për gratë të cilat kanë përjetuar dhunë seksuale në periudha të konfliktit të armatosur. Ky paraqet një element kritik të Rezolutës 1820 dhe paraqet një realitet edhe për situatën pas konfliktit në Kosovë. Çështja e drejtësisë tranzicionale dhe dhunës seksuale të kryer ndaj grave nuk është zgjedhur. Kjo Rezolutë duhet të shfrytëzohet për t'ua mohuar kriminelëve të luftës të drejtën e përfitimit të amnistisë. Për më tepër, Tribunali Ndërkombëtar për Krime Luftë në ish-Jugosllavi duhet të japë më shumë dënime më të rrepta për ata që kryejnë dhunime në mënyrë që t'i kontribuojnë rindërtimit të drejtësisë dhe t'i japin fund paprekshmërisë së dhunës seksuale të kryer ndaj grave gjatë luftërave.

Koalicioni Kosovar kundër dhunës në familje dhe dhunës seksuale përcakton strategjinë e vet

Koalicioni Kosovar kundër dhunës në familje dhe dhunës seksuale u takua në Durrës, mes 11 – 14 nëntor për të diskutuar strategjinë e koalicionit për vitin 2009 dhe strukturën e koalicionit në të ardhmen. Shtatë organizata e strehimore morën pjesë në këtë takim, përfshirë Qendrën për Mbrojtjen e Grave dhe Fëmijëve (Prishtinë dhe Mitrovicë) Medica Kosova (Gjakova), Liria (Gjilan), Qenda për Mirëqenien e Gruas (Pejë), Hope and Homes for Children (Prishtinë) dhe Shtëpia e Sigurt në Gjakovë. Takimi u udhëhoq nga Delina Fico me ndihmë nga Eli Krasniqi. Anëtarët bashkëpunuan në formulimin e vizionit, misionit, parimeve, strategjisë për vitin 2009, strukturës, proceseve të vendimmarrjes dhe përfaqësimit dhe komunikimit të Koalicionit, si përbrenda Koalicionit ashtu edhe me opinionin publik. Anëtarët e koalicionit u pajtuan që misioni i Koalicionit të jetë parandalimi i dhunës në familje dhe dhunës seksuale, si dhe përkrahja, ndihma dhe fuqizimi i të mbijetuarve të dhunës. Caqet strategjike për vitin 2009 janë:

- Zvogëlimi i rasteve të dhunës në familje apo dhunës seksuale duke përkrahur programet për barazi gjinore dhe kanalizim të çështjeve gjinore;
- Ngritja e vetëdijes;
- Kompletimi i kornizës ligjore;
- Ngritja e kapaciteteve; dhe
- Fuqizimi i Koalicionit.

Mes aktiviteteve të planifikuara përfshihen iniciativa për zvogëlimin e varfërisë në Kosovë; një fushatë 16-ditore me aktivitete kundër dhunës ndaj gruas; avokimi në lidhje me ligjin kundër dhunës në familje dhe Planin Kombëtar të Veprimit kundër Dhunës në Familje; monitorimi; bashkëpunimi në rregullimin e strehimoreve të licencuara; dhe sigurimi i buxheteve për strehimore.

Struktura organizative e Koalicionit përfshin Komitetin Drejtues të përbërë nga drejtorët ekzekutivë të strehimoreve si organi më i lartë i vendimmarrjes; Përfaqësuesin e Koalicionit që do të përfaqësojë Koalicionin; Koordinatorin e Koalicionit, një person të jashtëm që punon me gjysmë orari në organizimin e takimeve, mbajtjen e procesverbaleve, përgatitjen e projektpropozimeve dhe përpilimin e materialeve për marrëdhënie me publikun. Anëtarët e koalicionit kanë vendosur që grupi të mbetet joformal dhe të funksionojë përbrenda RRGK-së. Koalicioni do të takohet së paku një herë në dy muaj.

Më 20 nëntor, grupi u takua prapë për të diskutuar përmbajtjen e një Memorandumi të Mirëkuptimit mes Koalicionit dhe RRGK-së, përzgjedhjen e Përfaqësuesit të Koalicionit dhe atë se kush do të kërkojë fonde për aktivitetet e Koalicionit gjatë vitit 2009.

Koalicioni është themeluar vitin e kaluar dhe që atëherë ka funksionuar si grup joformal. Koalicioni ka përfituar nga përkrahja financiare e dhënë nga UNFPA dhe asistencë teknike e ofruar nga RRGK.

RRGK i dha kontributet e veta për Planin Suedez Kundër Dhunës në Baza Gjinore

Më 12 shtator, Agjencia Ndërkombëtare Suedeze për Zhvillim (SIDA) në Stokholm organizoi një konferencë me titull "Strategjitë e suksesshme për ndalimin e dhunës në baza në shoqëritë e pas konfliktit." Gratë e shoqërive të

konfliktit dhe pas konfliktit anembanë botës u mblodhën për të diskutuar faktorët që kontribuojnë në dhunën në baza gjinore dhe mënyrat për ta trajtuar atë. Pjesëmarrësit në konferencë shqyrtuan Planin kombëtar të veprimit të Suedisë kundër dhunës në baza gjinore dhe ofruan rekomandimet e tyre për avancimin e tij. Në fjalimin e saj, Drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së tha se forcat 'paqeruajtëse' ndërkombëtare shpeshherë përkrahin dhunën në baza gjinore përmes kërkesave të tyre për shërbime seksuale, gjë që kontribuon në rritjen e trafikimit seksual. Ajo theksoi edhe rëndësinë e përfshirjes së grave në negociatat paqësore, në pajtim me Rezolutën e KS të OKB-së 1325.

RRGK publikoi gjetjet e studimit të parë mbarëkosovar mbi dhunën në familje

Hulumtimi i parë i thukët i dhunës në familje në Kosovë, i titulluar "Siguria fillon në shtëpi", u bë publik më 27 nëntor në Hotelin Grand në Prishtinë. Agjencia për barazi gjinore që punon në kuadër të Zyrës së Kryeministrit me përkrahje të Iniciativës për Siguri dhe Qetësi të Grave pranë UNDP-së, kontrakttoi RrGGK-në për përpilimin e raportit. Gjetjet dhe rekomandimet do të shërbejnë si bazë për Planin dhe Strategjinë e parë Kombëtare të Veprimit kundër Dhunës në Familje.

RrGGK ka shfrytëzuar një metodologji të përzier e cila përfshinte mbledhjen e statistikave nga institucionet relevante; shqyrtimin ligjeve e legjislacionit relevant dhe shërbimeve sociale në dispozicion; duke anketuar 1,256 gra dhe burra të të gjitha moshave dhe grupeve etnike në Kosovë; dhe duke anketuar përfaqësues të institucioneve kosovare dhe ekspertë të organizatave relevante. Kapitujt e raportit përfshijnë:

1. Perceptimet e qytetarëve mbi dhunën në familje: Çka është abuzive dhe në çfarë rrethanash
2. Shpërhapja dhe format kryesore të dhunës në familje në Kosovë
3. Pasojat e dhunës në familje
4. Përgjigjet e qytetarëve: Metodot që qytetarët përdorin dhe propozojnë për ndalimin e dhunës apo zvogëlimin e rrethanave të saj

5. Kufizimet sociale që privojnë grupet e caktuara demografike të fushave private dhe publike, që kanë mundësi të rrisin dhunën në familje
6. Boshllëqet ligjore dhe institucionale në trajtimin e dhunës në familje

Raporti përfshin rekomandimet për reformat ligjore dhe legjislativë; Shërbimin Policor i Kosovës; Ministrinë e punës dhe mirëqenies sociale dhe Qendrat për punë sociale; Ministrinë e drejtësisë; Këshillin Gjyqësor të Kosovës; Ministrinë e ekonomisë dhe financave; Ministrinë e shëndetësisë; dhe Ministrinë e arsimit, shkencës dhe teknologjisë. Për qasje në raportin e plotë shkoni në: www.womensnetwork.org.

RrGGK iu përgjigj rasteve të dhunës në familje

Pas mbulimit të medieve të dy rasteve të rënda të dhunës në familje në Kosovë, RrGGK shkroi një botim në lidhje me dhunën në familje në Kosovë, i cili u botua në revistën Teuta. Si rrjedhojë e këtij reagimi përfaqësues të RrGGK-së, po ashtu, u ftuan në dy radio programe si dhe në TV21 për të biseduar mbi çështjen e dhunës në familje në Kosovë.

RRITJA E PËRFSHIRJES SË GRAVE NË NDËRTIMIN E PAQES NË NIVEL RAJONAL

Lobi Rajonal i Grave për Drejtësi, Paqe dhe Siguri

Lobi Rajonal i Grave për Drejtësi, Paqe dhe Siguri për Evropën Juglindore (EJL) organizoi një takim në Stamboll, Turqi më 17-19 maj të vitit 2008. Lobi Rajonal i Grave (LRG) përbëhet nga gra udhëheqëse prej Shqipërisë, Bosnje dhe Hercegovinës, Kroacisë, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë. Takimi u përqendrua në krijimin e strukturës për LRG-në, e cila do të përbëhet nga Komiteti Drejtues me nga një përfaqësuese nga secili prej shtatë shteteve. Përgjegjësitë e Komitetit Drejtues janë identifikimi i prioritetëve strategjike për veprim brenda çdo shteti, si dhe iniciativa tjera që mund të dalin. Kryesuese e Komitetit Drejtues është Edita Tahiri, politikanë nga Kosova. LRG do të mbështetet edhe nga Sekretariati i përbërë prej tri përfaqësuesve të UNIFEM-it, i cili do t'i koordinojë komunikimin, grumbullimin e fondeve dhe ngjarjet tjera. Së fundi, LRG do të themelojë edhe Bordin Këshillëdhënës të avokatëve të paqes dhe politikanëve të cilët mund të ndihmojnë me këshillime LRG-në në çështje të caktuara. Takimi rezultoi edhe me një deklaratë të LRG-së për qeveritë e Serbisë dhe Maqedonisë në lidhje me zgjedhjet, e vënë në dispozicion në faqen e internetit të RrGGK-së: www.womensnetwork.org.

Lobi Rajonal i Grave organizoi Konferencën në Prishtinë

Lobi Rajonal i Grave për Paqe, Siguri dhe Drejtësi në EJL (LRG) organizoi konferencën e parë publike me titull "Një e ardhme e sigurt për rajonin tonë: Çka duhet bërë për ta arritur? Gratë Lidere Flasin" më 27 tetor 2008 në Hotelin Grand në Prishtinë, me mbështetje të UNIFEM-it. Konferenca rezultoi në një deklaratë të miratuar nga anëtarët e LRG-së për paqe dhe siguri në EJL, që do të dorëzohet në Këshillin e Sigurimit të OKB-së në nëntor të vitit 2008 (në <http://www.rwlsee.org>). Po ashtu, një delegacion i LRG-së u takua me Presidentin e Kosovës, si dhe disa anëtare morën pjesë në dy debate televizive. Gjatë konferencës, anëtarët e LRG-së identifikuan prioritetet në vijim:

- Luftimi i krimit të organizuar, korrupsionit dhe dhunës në rajon;
- Adresimi i rolit që ka varfëria në zvarritjen e paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë rajonale; dhe

- Përqendrimi në drejtësinë kalimtare dhe rëndësinë e forumeve të tregimit të së vërtetës drejt pajtimit në rajon.

Përveç anëtareve të LRG-së, në konferencë folën edhe Presidenti i Kosovës, Fatmir Sejdiu, Ministri i punëve të brendshme, Zenun Pajaziti, Ministrja e drejtësisë, Nekibe Kelmendi, Ministrja e energjisë dhe minierave, Justina Pula dhe përfaqësues të EULEX-it dhe ZCN-së. Raporti i plotë i konferencës është në dispozicion në: <http://www.rwlsee.org/report.pdf>.

Koalicioni i Grave për Paqe vazhdoi bashkëpunimin

Anëtarët e Koalicionit të Grave për Paqe u takuan dy herë në Prishtinë për të formuluar planet për bashkëpunimet e ardhshme. Anëtarët mbajtën kontakte edhe përmes tri azhurnimeve të sigurisë që i këmbyen gjatë vitit RrGGK dhe Gratë në të Zeza gjatë vitit, që kishin të bënin me situatën e sigurisë. Organizatat anëtare të RrGGK-së, përfshirë Dera e hapur, ODA, Norma, Qendra kosovare për trajnime gjinore dhe resurse dhe Kalabria morën pjesë në takime të rrjetëzimit horizontal dhe në vizitat e bëra grave serbe në enklava ku ato ndanë informata me gratë serbe dhe organizatat serbe të grave si dhe identifikuan fushat për bashkëpunim në të ardhmen. KGP do të organizojë edhe një takim në fillim të dhjetorit në Prishtinë.

FUQIZIMI I KAPACITETEVE TË RRGK-SË DHE SHËRBIMIT TË ANËTAREVE TONA

RrGGK organizoi takimin e pestë vjetor

Më 1 dhjetor 2007, RrGGK-ja mbajti takimin e pjesë vjetor të anëtarëve në restorantin Hani i 2 Robertëve në Prishtinë, ku morën pjesë anëtarët e RrGGK-së, stafi, partnerët dhe përkrahësit. Drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së, Igballe Rogova, prezantoi punën e RrGGK-së nga dhjetori i vitit 2006 deri në dhjetor 2007. Gjatë kësaj periudhe, RrGGK-ja realizoi misionin e saj duke vazhduar ndërtimin e kapaciteteve, duke marrë pjesë në takime ndërkombëtare dhe vendore, si dhe përmes avokimit në nivel lokal dhe rajonal.

Raporti i aktiviteteve të RrGGK-së për vitin 2007, i shpërndarë gjatë takimit, përshkruante punën e RrGGK-së në vitin 2007: anëtarët e RrGGK-së vazhduan të mbajnë takime të rregullta dy herë në vit; bordi i zgjedhur i RrGGK-së u takua tri herë; RrGGK publikoi katër botimet e buletinit të tij "Zëri i gruas kosovare" në shqip, anglisht dhe serbisht; RrGGK ndihmoi Qendrën Kosovare kundër kancerit të gjirit në organizimin e fushatave për ngritjen e vetëdijes për kancerin e gjirit; Koalicioni i Grave për Paqe organizoi konferencën e dytë në Strugë të Maqedonisë; RrGGK organizoi ligjërata në kapet e KFOR-it për sensibilizim mbi Rezolutën e KS të OKB-së 1325; RrGGK edukoi votuesit dhe monitoroi fushatën zgjedhore të zgjedhjeve të nëntorit në Kosovë; dhe RrGGK mbështeti financiarisht strehimoret në Kosovë si dhe ka kryer një hulumtim që rezultoi me raportin me titull Hulumtimi kërkimor mbi dhunën në baza gjinore dhe ndikimin e saj në shëndetin riprodhues në Kosovë.

Gjatë takimit vjetor, anëtarët diskutuan për revidimin e zbatimit të Kodit të Etikës dhe Përgjegjshmërisë së RrGGK-së dhe zgjodhi anëtarët e komisionit të parë për Kod të Mirësjelljes, që do të jetë përgjegjës për të vlerësuar nëse anëtarët e RrGGK-së janë duke iu përmbajtur Kodit të Mirësjelljes. Anëtarët e RrGGK-së propozuan ekspertë për këtë komision dhe pastaj zgjodhën këto anëtare: Cyme Mahmutaj, Delina Fico, Linda Gusia dhe Teuta Sahatçia

Gjatë lojës vjetore të fatit të RrGGK-së, tetë organizata anëtare fituan shpërblime; Alma në Pejë fitoi një kompjuter desktop; Gratë për gratë fitoi një kamerë digjitale; Medica fitoi një kompjuter desktop; Lepsa Buducnost, Dera e hapur dhe Dora Dorës fituan kartela mbushëse për telefon në vlerë prej 20 euro; Dora e Ngrohët fitoi një 1GB USB; dhe Hareja fitoi një pajisje të kombinuar skaner-fotokopje.

Anëtarët e RrGGK-së vlerësuan punën e RrGGK-së në vitin 2007. Raporti i bazuar në këto vlerësime është shpërndarë gjatë takimit të radhës së anëtarëve të RrGGK-së më 9 shkurt 2008.

RrGGK organizoi gjashtë takime të rregullta të anëtareve

RrGGK ka mbajtur gjashtë takime të anëtarëve. Këto takime ofruan mundësin e një forumi për anëtarët për pranimin e informatave të reja mbi programet e RrGGK-së, për këmbim të informatave dhe përvojave, si dhe për inicim të aktiviteteve të përbashkëta. Takimet u mbajtën më 9 shkurt, 7 prill, 5 maj, 2 qershor, 2 shtator dhe 3 nëntor.

RrGGK vazhdoi publikimin e buletinit tremujor

RrGGK vazhdoi me publikimin e buletinit "Zëri i Gruas Kosovare". Tri botime të buletinit tremujor të RrGGK-së kishin informata mbi RrGGK-në dhe aktivitetet e anëtarëve të saj. Buletini është shpërndarë edhe në formë elektronike edhe në kopje fizike në tri gjuhë: shqip, serbisht dhe anglisht.

RrGGK përfshiu anëtarët e bordit dhe kishte ndryshime në bordin e RrGGK-së

Bordi i drejtorëve i RrGGK-së dhe Bordi këshillëdhënës u takuan katër herë në vitin 2008, më 24 janar, 28–29 mars në Tiranë, 23 korrik, dhe 24–25 tetor në Strugë. Gjatë takimit në Tiranë, Bordi i drejtorëve i RrGGK-së në bashkëpunim me stafin krijoi dhe miratoi strategjinë e RrGGK-së për 2008–2010. Drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së, po ashtu, mbajti kontakte të rregullta me anëtarët e RrGGK-së, duke ofruar informata të reja përmes email-it dhe telefonit, si dhe për të kërkuar këshilla, sipas nevojës.

RrGGK vazhdimisht ndau informata në nivel vendor dhe ndërkombëtar

RrGGK ka ofruar informata përmes faqes së internetit dhe komunikimeve me email me hulumtuesit, shkrimtarët dhe aktivistët e saj, kudo në botë. Për shembull, RrGGK ka mbajtur korrespondencë të rregullt me Projektin e avokimit, i cili ka postuar blog-e dhe artikuj mbi punën e RrGGK-së dhe anëtarëve të saj. Veç kësaj, përfaqësues të RrGGK-së morën pjesë në intervistime të shumta me gazetarë të RTV21, RTK, KTV, Lajmi, Express, Koha Ditore, Kosova Sot, revista Teuta, Radio Dukagjini, Radio Kosova, Televizioni Opinion, një gazetë ditore finlandeze,

një revistë spanjolle për gratë, një revistë për gra në Francë, një gazetë ditore austriake, norvegjeze, suedeze, kanal in tetë dhe kanal in një të Suedisë. Përfaqësueset e RrGGK-së u intervistuan edhe nga organizata ndërkombëtare si UNDP, OSCE, the Mott Foundation, The Advocacy Project, Human Rights Watch dhe Amnesty International. RrGGK në veçanti ndau informata mbi planin gjashtë-pikësh për Kosovën të propozuar nga Sekretari i përgjithshëm i OKB-së; përpjekjet e grave për pjesëmarrje në vendimmarrje; përpjekjet e grave për avancimin e paqes në rajon; dhe për dhunën në familje.

RrGGK ofroi shërbime për anëtarët

Çdo vit në takimin vjetor të anëtarësisë, RrGGK ka kërkuar nga organizatat anëtare që të bëjnë një vlerësim të rrjetit dhe të parashtrajnë sugjerime për përmirësimin e punës së tij. Vitin e kaluar, 56.1 për qind e anëtarëve kishin kërkuar më shumë informata nga RrGGK. Ne kemi bërë përpjekje shtesë për të shpërndarë informata këtë vit përmes email-it dhe telefonit. Për shembull, RrGGK ka përcjellë informata mbi mundësitë e ndryshme të financimit për pjesëtarët (p.sh., thirrjet për propozime) dhe ka ndarë informata te anëtarët mbi ngjarje të ndryshme.

Më shumë se 70 për qind e anëtarëve kanë kërkuar më shumë programime dhe përpjekje të përbashkëta. Në vitin 2008, RrGGK-ja është munduar të mbështetë më shumë programime të përbashkëta përmes: iniciativës Zëri i Votuesve, që mbledhi anëtarët për të planifikuar takime me qytetarë në 10 komuna të Kosovës, për ofrimin e mbështetjes teknike për Koalicionin kundër dhunës në familje dhe dhunës seksuale, si dhe për financimin e disa takimeve të përbashkëta ndërmjet anëtarëve.

85 për qind e anëtarëve kanë kërkuar asistencë në kontaktim me donatorë. RrGGK ka ndihmuar në ngritjen e fondeve përmes mbështetjes teknike, hartimit të propozimeve, lidhjes së organizatave me donatorë, negocimit me donatorë në emër të anëtarëve, dhe/apo hartimit të rekomandimeve për Medica Kosova, Dera e hapur, Komiteti i grave të verbra dhe Qendra kosovare për luftimin e kancerit të gjirit Jeta Vita.

RrGGK mirëpriti studentë ndërkombëtarë

Më 17 janar 2008, një grup i studentëve nga Qendra Evropiane Ndër-Universitare për të Drejta të Njeriut dhe Demokratizim, me seli në Venedik, vizitoi RrGGK-në. Ky universitet, i cili bashkëpunon me studentë të Universitetit

të Prishtinës, dërgon çdo vit studentë për të vizituar institucionet kosovare dhe RrGGK-në. Gjatë takimit, ata diskutuan për situatën aktuale politike të Kosovës dhe statusin e grave në Kosovë.

Më 18 shkurt, një grup tjetër i studentëve nga Universiteti i Torontos vizitoi RrGGK-në. Grupi, i udhëhequr nga Ylber Kusari, i cili aktualisht kryen studimet Master në Kanada, kishte mundësinë të dëgjojë për rolin që organizatat e grave në Kosovë kanë luajtur para, gjatë dhe pas luftës. Studentët ishin vizitorët e parë të RrGGK-së pas shpalljes së pavarësisë.

OJQ-të japoneze mësuan per organizimet e shoqerise civile në Kosovë

Më 2 shkurt 2008, Drejtoresha ekzekutive e RrGGK-së, Igballe Rogova, udhëhoqi një seminar për 100 OJQ japoneze gjatë "Seminarit për mbështetje të demokracisë për OJQ-të japoneze," në Institutin për bashkëpunim ndërkombëtar, pranë Agjencisë për bashkëpunim ndërkombëtar të Japonisë në Tokio. Organizata vullnetare Shanti në Tokio, organizoi një seminar, me komisionim të Divizionit për të drejta të njeriut dhe çështje humanitare, Byrosë për politikë të jashtme të Ministrisë së Jashtme të Japonisë. Seminare kishte për synim ndërtimin e kapaciteteve të OJQ-ve japoneze në punë për mbështetje të demokracisë në shtetet në zhvillim dhe për t'i ofruar atyre njohurinë e duhur për të aplikuar për fonde nga Fondi i OKB-së për Demokraci (UNDEF). Preeti Shroff-Mehta nga World Learning, ofroi një vështrim në OJQ-të, si dhe aty foli edhe kreu i UNDEF, Roland Rich.

Bazuar në përvojën e saj në organizimin e projekteve të demokracisë në Kosovë, Rogova paraqiti shembuj konkretë mbi mënyrat që OJQ-të japoneze mund të zbatojnë projektet të demokracisë në Japoni dhe jashtë vendit. Aktivistet japoneze diskutuan me RrGGK-në mbi atë se si paragjykohet sistemi i njëanshëm i donatorëve që përdoret nga OKB karshi organizatave jo anglofolëse, si dhe, në anën tjetër, si shpërblehen propozimet e shkruara në anglishte të mirë me terminologji të OKB-së përderisa refuzohen propozimet me potencial të cilësisë më të mirë që nuk e shfrytëzojnë atë terminologji apo anglishten e përsosur. Krahas seminarit, përfaqësues të RrGGK-së vizituan dy organizata të grave në Tokio. OJQ-të japoneze ishin shumë të interesuara në punën e OJQ-ve kosovare dhe shprehën interesim për të vizituar Kosovën në mënyrë që të mësojnë më shumë dhe të bashkëpunojnë për iniciativa të ardhshme të përbashkëta.

"Gratë, fytyra e harruar e luftës" shfaqi premierën e saj në Kosovë

Më 4 qershor në Teatrin Oda në Prishtinë, prodhuesit e filmave Susan Muska dhe Greta Olafsdottir shfaqën premierën e dokumentarit të tyre, "Gratë, fytyra e harruar e luftës", me mbështetje të RrGGK-së. Filmi dokumentar paraqet tregimet e nëntë grave gjatë luftës në Kosovë: Sevdie Ahmeti, Ardiana, Brita, Ema, Aferdita, Nafie, Tatiana, Kada dhe Kosovare Kelmendi. Filmi hulumton efektet e luftës dhe humbjes së familjes në gra. Ky film dokumentar shqyrton edhe çështjen e përdhunimeve si armë e përdorur kundër grave gjatë luftës. Përkundër mundimeve të tyre, të gjitha këto gra kanë përcjellë një mesazh të forcës. Qëndrueshmëria e tyre ka dëshmuar se gratë dhe fëmijët janë me të vërtetë "substancia e shoqërisë". Përderisa shumë kriminelë të luftës (si Radovan Karadzic dhe Ratko Mladic) nuk sillen para drejtësisë, këto gra luftojnë dhe kërkojnë të ndihmojnë të tjerat sepse ato nuk kanë pranuar që shoqëria e tyre të shkatërrohet.

RrGGK ndau përvojat me aktiviste të Lindjes së Mesme

Nga 20-22 maj 2008, grupe të grave nga Izraeli dhe Palestina u mbledhën në Jordani në një konferencë të organizuar nga Kvinna till Kvinna. Takimi ofroi mundësi për diskutime të hapura për çështjet me të cilat gratë përballen në të dyja shoqëritë: diskriminimi, militarizmi dhe dhuna seksuale. Grupet pjesëmarrëse ishin organizata partnere me Kvinna till Kvinna.

Kvinna till Kvinna ftoi Drejtoreshën ekzekutive të RrGGK-së, Igballe Rogova, që të marrë pjesë në konferencë dhe të flasë për aktivitetet e RrGGK-së. Ajo foli për metodat që RrGGK ka shfrytëzuar për monitorimin e zbatimit të Rezolutës së KS të OKB-së 1325 mbi Gratë, paqen dhe sigurinë, si dhe për zhvillimin e Koalicionit Paqësor të Grave, një koalicion ndërmjet aktivisteve në Serbi dhe Kosovë. U shfaq edhe një film dokumentar i punuar nga RTV21 mbi Koalicionin Paqësor të Grave. Filmi ishte prekës dhe inspirues për grupet e grave izraelite dhe palestineze të cilat punonin në themelimin e një koalicioni të ngjashëm dhe në adresimin e synimeve të ngjashme në Lindjen e mesme.

RrGGK mori pjesë në një takim rajonal të organizuar nga Fondacioni Kvinna till Kvinna

Më 27-29 tetor, Fondacioni Kvinna till Kvinna (KtK) organizoi një takim rajonal në Strugë. Ata mbledhën së organizatave e tyre partnere nga Kosova, Shqipëria dhe Mali i Zi për të diskutuar mbi shëndetin fizik dhe psikologjik të grave.

RrGGK monitoroi zbatimin e Kodit të Mirësjelljes

Pas korigjimeve në Kodin e mirësjelljes së RrGGK-së, bazuar në komentet e anëtarëve, përfaqësues të RrGGK-së u takuan me organizatat anëtare të RrGGK-së për të mbushur aplikacionin. Me përdorimin e këtyre aplikacioneve, RrGGK ka përpiluar edhe profilet e organizatave anëtare, që do të postohen në faqen e internetit të RrGGK-së dhe do të publikohen në një pamflet mbi anëtarët vitin e ardhshëm.

BORDI I DREJTORËVE TË RRGK**Bordi i Drejtorëve të RrGGK-së gjatë vitit 2008:**

Belgjyzare Muharremi – Kryesuese e Bordit - (Dera e Hapur)
 Arjeta Rexhaj (Qendra për Trajnime dhe Hulumtime Gjinore)
 Behar Selimi (Sherbimi Policor i Kosovës)
 Besim M. Kajtazi (Ministria e Shërbimeve Publike)
 Marte Prenkpalaj (Shoqata Motrat Qiriazhi)
 Nazlije Bala (Aktiviste për të drejtat e grave)
 Veprorë Shehu (Medica Kosova)

Bordi i Drejtorëve për vitin 2009:

Belgjyzare Muharremi - Kryetare e Bordit (Dera e Hapur)
 Ariana Qosja - Mustafa (KCDF)
 Arjeta Rexha (Qendra për Trajnime dhe Studime Gjinore)
 Behar Selimi, (Shërbimi Policor i Kosovës)
 Nazlije Bala (Aktiviste për të drejtat e grave)
 Shukrije Gashi (Partners Kosova)
 Veprorë Shehu (Medica Kosova)

Bordi Këshillues:

Vjosa Dobruna (Aktiviste për të Drejtat e Njeriut)
 Delina Fico (Aktiviste për të drejtat e grave)
 Besim M. Kajtazi (Ministria e Shërbimeve Publike)
 Marte Prenkpalaj (Motrat Qiriazhi)
 Rachel Wareham (Këshilltare e Pavarur)



STAFI I PËRHERSHËM I RRGK GJATË VITIT 2008

Igballe Rogova – Drejtoreshë Ekzekutive

Aida Dërguti – Menaxhere e projektit

Besa Shehu – Menaxhere për financa

Alba Loxha – Menaxhere për Informim dhe Qasje

STAFI I PROJEKTEVE PËR VITIN 2008

Nicole Farnsworth – Këshilltare dhe Hulumtuese

Adelina Berisha – Hulumtuese

Mimoza Gashi – Hulumtuese

Dafina Beqiri – Koordinatore e Projektit për Kodin e Mirësjelljes së RRGK-së

Nicole Slezak – Praktikante e Projektit për Avokim (qershor-gusht)

Raporti Vjetor i Auditit të RrGGK-së



RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për: MENAXHIMENTIN EKZEKUTIV TË RRJETIT TË GRAVE TË KOSOVËS
(RRGK) PRISHTINË

Ne kemi audituar kostot financiare dhe të dhënat plotësuese të Rrjetit të Grave të Kosovës (RRGK) të shprehura në EUR, për periudhën janar-dhjetor 2008. Këto pasqyra financiare dhe të dhënat plotësuese financiare janë përgjegjësi e menaxhmentit të projekteve. Përgjegjësia jonë është që të shprehim një mendim mbi informatat e lartpërmendura financiare bazuar në auditimin tonë.

Ne kemi kryer auditimin në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA). Këto standarde kërkojnë që të planifikojmë dhe ta zbatojmë auditimin për të marrë një siguri të arsyeshme se a i përmbajnë formularët për raportim deklaratat e gabuara. Një auditim përfshin ekzaminimin, në bazë të një prove, dëshmi që mbështet shumat dhe zbulimet në formularët për raportimin. Një auditim gjithashtu përfshin vlerësimin e parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe vlerësimet e rëndësishme të bëra nga menaxhmentit, si dhe vlerësimin e duhur të kontabilitetit dhe raportimin e të dhënave në pasqyrat financiare. Ne besojmë se auditimi i ynë, ofron një bazë të arsyeshme.

Sipas mendimit tonë, të dhënat financiare, në mënyrë të drejtë i paraqesin të gjitha aspektet materiale, si dhe shpenzimet e Rrjetit të Grave të Kosovës që nga 31 Dhjetori 2008, dhe rezultatet e operacioneve, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit dhe Standardet e Kontabilitetit të Kosovës.

Blerim Krasniqi
Auditor i licencuar
"Haki Pavataj" 15
Prishtinë
Republika e Kosovës
Tel: ++377 44 480 222
Faks: +381 38 542 551


BLERIM KRASNIQI
Auditor i Licencuar
Licensed Auditor

Prishtinë
24 Maj 2009

RAPORTI FINANCIAR I RRGK-SË PËR VITIN 2008

Donatorët	Projektet	Të bartura nga v.2007	Të pranuar	Shpenzimet	Mbetja
1 UNDEF ('07 - '08)	Rrjetëzimi i Grave për Paqe dhe Stabilitet Rajonal	35,560.59	68,461.39	88,944.39	15,077.59
2 Ambasada Britanike	Iniciativa Qytetare për Qeverisje të mirë		31,686.42	21,338.42	10,348.00
3 UNIFEM (2007-2008)	Fuqizimi i Grave në Vendimarrje	3,600.00	2,400.0	6,000.00	-
4 UNDP / WSSI	Hulumtim për Format e Dhunës në Familje		16,340.00	16,340.00	-
5 Fondacioni MOTT	Përkrahje Institucionale për RrGGK		20,400.87	19,900.87	500
6 Kvinna till Kvinna	Fuqizimi i Kapaciteteve të RrGGK për Avokim	983	32,514.00	32,797.00	700
7 UNFPA	Përkrahje Koalicionit të Strehimoreve		7,040.00	7,040.00	-
8 UNIFEM Austria	Qasja e Grave në Përkujdesjen Shëndetësore		20,000.00	20,000.00	-
9 Kvinnor till Kvinnor	Përkrahje Anëtareve në Aktivitete		4,000.00	4,000.00	-
10 OSBE	Qeverisja e mirë përmes Edukimit të Votuesve		5,099.22	5,099.22	-
11 Projekte që kanë vazhduar nga 2007		27,467.82	-	27,467.82	-
Totali		67,611.41	207,941.03	248,927.72	26,625.59

Kostot Operative dhe Programatike të RrGGK-së 2008



Mjetet e dhuruara nga RrGGK për organizatat anëtare

OJQ Komiteti për gratë e verbra	€ 700
OJQ Alma	€ 800
OJQ Dera e Hapur	€ 200
OJQ Legjenda	€ 150
OJQ Flaka	€ 200
OJQ Lulishtja	€ 200
OJQ Lidhja e gjalle	€ 200
OJQ Motrat Qiriaz	€ 250
OJQ Jeta Vita	€ 150
OJQ Antigona	€ 200
OJQ Dora e Ngrohtë	€ 250

Gjithsej € 3,300

Lista e inventarit të dhuruar nga RrGGK për organizatat anëtare

OJQ Ruka Ruci	1 faks 1 thithëse elektrike
OJQ Dora e Ngrohte	1 kompjuter 1 tryezë pune 1 UPS bateri 1 sistem zërimi
OJQ Shoqata për edukimin dhe përkujdesjen e familjes	1 kompjuter 1 tryezë pune
OJQ Motrat Qiriaz	1 kompjuter
OJQ Jeta Vita	5 karrige për zyrë
OJQ One to One Kosova	1 kamerë
OJQ Gratë për Gratë	1 kamerë
OjQ Hareja	1 printer/skaner/fotokopje
OJQ Alma	1 kompjuter
OJQ Medica Kosova	1 kompjuter

STRATEGJIA E RRGK-SË PËR VITIN 2009

Bordi i Drejtorëve të RrGGK-së miratoi strategjinë për vitin 2009 në takimin e mbajtur në Strugë më 24 dhe 25 tetor 2008. Strategjia kontribuon në tri objektiva organizative të RrGGK-së përmes gjashtë programeve dhe aktiviteteve korresponduese:

Sigurimi i pjesëmarrjes së barabartë, efektive dhe aktive të grave dhe vajzave në zhvillimet politike, ekonomike dhe sociale të Kosovës

Programi 1. Rritja e pjesëmarrjes së grave në politikë dhe vendimmarrje

- 1.1 Raporti i progresit që monitoron zbatimin e Rezolutës së KS të OKB 1325.
- 1.2 Fushata për ngritjen e vetëdijes mbi mekanizmat për barazi gjinore në Kosovë.
- 1.3 Avokim për rritjen e pjesëmarrjes së grave në Sektorin e Sigurisë (Këshilla për Agjencinë e sigurisë dhe inteligjencës)
- 1.4 Takime koordinuese dhe bashkëpunimi me partitë politike (mbështetje për aktivitetet e Qendrës për trajnime dhe studime gjinore)

Programi 2. Fuqizimi për votuesit

- 2.1 Asistimi i votuesve me fushata të avokimit neper komuna
- 2.2 Pranimi i vazhdueshëm i ankesave dhe sugjerimeve për politikanët nga qytetarët
- 2.3 Fushatë – promovim i vazhdueshëm medial i rasteve kur ankesat janë adresuar dhe të rasteve të avokimit të suksesshëm

Përmirësimi i të drejtave të njeriut të grave në të gjitha sferat e jetës në Kosovë

Programi 3. Përmirësimi i shëndetit të gruas

- 3.1 Ekzaminime mjekësore për gratë në zonat rurale me ambulantë mobile
- 3.2 Mbështetje për fushatën kundër kancerit të gjirit

- 3.4 Kontribut për përgatitjen e Strategjisë së Kosovës kundër kancerit të gjirit
 3.5 Raporti i vlerësimit mbi kapacitetin e sistemit publik shëndetësor përkitazi me shëndetin e gruas

Programi 4. Ulja e trafikimit dhe dhunës në familje

- 4.1 Mbështetje për koalicionin kundër familjes dhe dhunës seksuale
 4.2 Kontribut dhënë Strategjisë dhe Planit të Veprimit të Kosovës kundër dhunës në familje
 4.3 Avokim, kontribut për hartim dhe më vonë, monitorimi i zbatimit të Ligjit kundër Dhunës në familje

**Përmirësimi dhe rritja e bashkëpunimit ndërmjet
 grupeve dhe organizatave të grave në Kosovë, rajon dhe ndërkombëtarisht**

Programi 5. Rritja e përfshirjes së grave në ndërtimin rajonal të paqes

- 5.1 Rrjetëzimi dhe bashkëpunimi me organizatat e grave nga Maqedonia, Shqipëria dhe Mali i Zi (për kuo-
 tat dhe dhunën kundër gruas)
 5.2 Mbështetja dhe fuqizimi i organizatave të grave serbe në Kosovë
 5.3 Mbështetja për Rrjetin e grave ballkanike për paqe

Programi 6. Fuqizimi i kapacitetit të rrjetit

- 6.1 Buletini tremujor "Zëri i gruas kosovare"
 6.2 Raportet vjetore
 6.3 Monitori i zbatimit të Kodit etik dhe të përgjegjshmërisë së RrGGK-së
 6.4 Përgatitja e një broshure me profilet e organizatave anëtare të RrGGK-së
 6.5 Mbështetja e organizatave anëtare të RrGGK-së përmes profilizimit dhe korrespondencës me
 donatorë (ndoshta në formë të një prezantimi)
 6.6 Azhurnimi i vazhdueshëm i faqes së internetit të RrGGK-së
 6.7 Shërbime për organizatat anëtare të RrGGK-së: mbështetje në ngritjen e fondeve, përkthime,
 trajnime.

Anëtares e RrGGK-së**Ajo**

Maria Kurti
 044 286 319
 ugaferodita@hotmail.com
 Ferizaj

Alma

Shemsije Seferi
 044 257 443
 shemsijeseferi@hotmail.com
 Sverkë, Pejë

Antigona

Rabe Rrustemi
 044 192 232
 r_rrustemi@hotmail.com
 Skenderaj

Asebe

Esmë Karanezi
 044 128 126
 Prizren

Ato

Fikrije Ferizi
 044 332 558
 qendraegruas_ato@hotmail.com
 Vushtrri

Aureola

Sanije Grajçevci
 044 502 578
 aureola_p95@hotmail.com
 Prishtinë

Bardha

Raza Sadrija
 044 104 126
 Prishtinë

Briga

Miroslavka Simonovic
 063 7210 616
 miroslavkabriga@yahoo.com
 Gorazdevac

Centari Romani Gjuvlenge

Emsale Mergjollari
 044 274 671
 emsalemergjollari@hotmail.com
 Prizren

Dera e Hapur

Belxhyzare Muharremi
 044 124 423
 betimuharremi@hotmail.com
 Prishtinë

Diana

Silvana Vokshi
 044 769 778
 Gjakovë

Dora Dorës

Vjosa Curri
 044 216 616
 dora_dores@yahoo.com
 Prishtinë

Dora e Ngrohtë

Drita Rama
 044 264 102
 drita.g.rama@gmail.com
 Rahovec

Drita

Fexhrie Mavriqi
 044 350 823
 febimav@yahoo.com
 Prishtinë

Dua

Ilijana Kryeziu
 044 309 439
 oj_q_dua@yahoo.com
 Prizren

Edona

Hafize Hajdini
044 657 920
ngoedona@yahoo.com
Ferizaj

Elena Gjika

Lale Grabanica
044 199 167
grabanica@hotmail.com
Klinë

Familja dhe Shpresa

Atifete Bytyqi
044 329 196
atifetebytyqi@hotmail.com
Klinë

Femra në Veprim

Kadrije Piliqi
044 227 820
kpiliqi@yahoo.com
Kaçanik

Flaka

Shehindere Dedushi
044 195 940
delidedushi@hotmail.com
Lipjan

Foleja

Gjyzel Shaljani
044 219 612
gjyzelshaljani@gmail.com
Prizren

Fortesa

Sanije Jahiri
044 643 665
sanije200@hotmail.com
Kamenicë

Gruaja Familjare

Nadire Kryeziu
044 217 223
gruaja_familjare@hotmail.com
Prizren

Gruaja për Gruan

Shemsije Xhaferi
044 155 286
xhaferi_shemsije@hotmail.com
Rahovec

Grupi i Veteranëve të Arsimit

Naxhije Buçinca
044 233 633
naxhi_gva@yahoo.com
Prishtinë

Hadër

Resmije Krasniqi
044 278 538
haderprizren@hotmail.com
Prizren

Handikos

Drita Vukshinaj
044 263 636
handikos_pz@hotmail.com
Prizren

Handikos

Mehreme Llumnica
044 198 688
mehremellumnica@hotmail.com
Prishtinë

Hanëmeli

Lirije Gash
044 343 709
liriyegas@hotmail.com
Prishtinë

Hareja

Sahadete Dula
044 204 321
shpg.hareja@hotmail.com
Prizren

Jeto Jetën

Xhylnaze Bytyqi
044 187 021
jetojeten@hotmail.com
Prizren

Kalabria

Sevdie Bunjaku
044 234 190
kalabria24@hotmail.com
Prishtinë

Kevser

Igballe Berisha - Huduti
044 142 038
kewther_pz@yahoo.com
Prizren

Komitet Zena za Zastitu i Ljudska Prava

Snezana Karadzic
044 929 676
snezana.karadzic@gmail.com
Caglavica

Komiteti i Grave të Verbëra

Bajramshahe Jetullahu
044 185 298
kgvk_b@hotmail.com
Prishtinë

Koraci Buducnosti

Smiljana Veselinovic
038 64 202
Gracanica

Kreativa

Klara Baraku – Idrizi
044 145 744
shoqata_kreativa@hotmail.com
Prishtinë

Legjenda

Melihate Osmani
044 194 045
meliosmani@yahoo.com
Viti

Lepsa Buducnost

Radosava Mirkovic
064 533 7885
lepsa.buducnost@yahoo.com
Priluzje

Lira

Valire Buza
044 189 775
valirebuza@hotmail.com
Prishtinë

Idemo Pravo

Zhivadinka Radosavlevic
064 447 0 967
Plemetin

Indira

Lize Marku
044 963 727
l_marku@hotmail.com
Videjë/Klinë

Institute of Psychology

Myrrete Bajrami
044 209 017
mbajrami@gmail.com
Prishtinë

Jeta

Safete Gacaferri
044 253 412
ojqjeta@yahoo.com
Deçan

Jeta Ime

Shqipe Bejtullahu
044 188 336
mylife_center@yahoo.com
Gjakovë

Liria

Nazife Jonuzi
044 125 729
liriagjilan@hotmail.com
Gjilan

Liria

Luljeta Kuqi
044 186 824
luljeta_kuqi@hotmail.com
Suharekë

Lulebora

Selvete Gashi
044 110 970
ojqlulebora@yahoo.com
Prishtinë

Lulishtja

Sadije Dulahu
044 374 412
sadedulahu@hotmail.com
Dabishevc

Luna

Stanica Kovacevic
044 738 590
028 467 335
Fushë Kosovë

**Mental Disability Rights
International**

Zamira Hyseni
044 176 287
zhyseni@mdri.org
Prishtinë

Medica Kosova

Veprora Shehu
044 188 316
medicam_kosova@yahoo.com
Gjakovë

Motrat Qiriazzi

Marte Prenkpalaj
044 113 258
motratqiriazizhas@yahoo.com
Has / Prizren

Nardi

Violeta Shehu
044 450 184
nardi_99@hotmail.com
Prishtinë

Ne Jemi Pjesë e Botës

Atifete Demaj
044 239 814
njpb05@hotmail.com
Fushë Kosovë

Norma

Valbona Salihu
044 126 428
shoqatanorma@yahoo.com
Prishtinë

Oda

Violeta Selimi
044 318 982
vselimi.oda@gmail.com
Prishtinë

OGPK

Rudina Gerdeci - Llapashtica
044 308 758
aibi@hotmail.com
Prishtinë

One to One Kosova

Merita Halitaj
044 172 644
onetoonekosove@hotmail.com
Prizren / Pejë

OPER

Nurije Ferati - Haziri
044 257 316
nurije.ngo.oper@hotmail.com
Prishtinë

Promocom

Blerta Nezaj
044 145 554
ngo_promocom@yahoo.com
Gjakovë

**Qendra Kosovare për Luftimin
e Kancerit të Gjirit Jeta/Vita**

Nafije Latifi
044 145 530
jeta.vita@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra Kosovare për
Rehabilitimin e të Mbijetuarve
të Torturës**

Feride Rushtini
044 501 904
krct_org@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra Kosovare për Studime
Gjinore**

Luljeta Vuniqi
044 116 898
qksgj_kgsc@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra për Mbrojtjen e Grave
dhe Fëmijëve**

Naime Sherifi
044 508 081
cpwcprishtina@yahoo.com
Prishtinë

**Qendra për Mbrojtjen e
Viktimave dhe Parandalimin e
Trafikimit me Qenie Njerëzore**

Hamijet Dedolli
044 167 395
hamijet_dedolli@yahoo.com
Prishtinë

Qendra për Mirëqenien e Gruas

Lumnije Deçani
044 111 678
pejawwc@yahoo.com
Pejë

**Qendra për Strehimin e Grave
dhe Fëmijëve**

Nora Hoxha
044 126 568
qsgf_pz@hotmail.com
Prizren

**Qendra për Trajnime dhe
Studime Gjinore**

Arjeta Rexha
044 124 612
qtsgj@yahoo.com
Prishtinë

Qendra Resurse e OJQ-ve

Esma Smajli
029 631 357
ngoprizren@yahoo.com
Prizren

Romane Romnja

Shpresa Agushi
044 211 905
agushishpresa@yahoo.com
Gjilan

Ruka + Ruci

Nevenka Rikallo
044 839 986
rikalonevenka@yahoo.com
Fushë Kosovë

Sara

Dashurie Sahiti
044 373 036
dashurijesahiti@yahoo.com
Dragash

SHE - ERA

Mirlinda Kusari
044 122 696
wsheera@gmail.com
Gjakovë

Shoqata e Amviseve të Kosovës

Gjylfidane Morina
044 394 226
danemorina@yahoo.com
Prishtinë

Shoqata Këshilluese Edukative

“Ujesa”

Shukrije Bytyqi
044 382 331
shke_ujesa@yahoo.com
Malishevë

**Shoqata për Edukimin dhe
Përkujdesjen e Familjes**

Bahrije Deva
044 152 051
shepfgjakova@yahoo.com
Gjakovë

Shpresa

Sabrije Kukaj
044 170 652
sabrijekukaj@hotmail.com
Drenas

Shpresa & Shtëpitë e Fëmijëve

Valbona Çitaku
044 200 353
sdsf_ks@yahoo.com
Prishtinë

Shtëpia e Sigurtë

Sakibe Doli - Dobruna
044 161 857
linjajuaj@yahoo.com
Gjakovë

Shtjefën Gjeçovi

Shpresa Siqeca
044 350 023
shpresasiqeca808@yahoo.com
Prizren

Sibora

Hyrmete Celina
044 247 240
sibora_pz@yahoo.com
Prizren

Teuta

Nexhmije Bytyqi
044 216 623
nexhmijeb@yahoo.com
Prizren

Venera

Miradije Gashi
044 223 418
ngo_venera@live.com
Pejë

Violete

Bedrije Shala
044 317 541
bedrije.shala@hotmail.com
Barilevë / Prishtinë

Vita - Jeta

Ajshe Nuhiu
044 277 421
ajshenuhiu@yahoo.com
Prishtinë

Zana

Tahire Gashi
044 406 812
shg_zana@hotmail.com
Klinë

Raporti Vjetor 2008
Rrjetit të Grupeve të Grave të Kosovës

© 2008 Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës
Rr. Hajdar Dushi C-2, II / 8, Prishtinë, Kosovë

Lejohet e drejta për ribotim.

**Përpiluar dhe Dizajnuar nga
ALBA LOXHA**

**Financuar nga
MOTT Foundation**